



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHITIME
Nr.01-060/01-10015/22 datë:19.04.2022



Npi – 01/95 datë: 29.04.2022

Bazuar në nenin 12.2. pika (c), nenin 40.2 pika (g), dhe nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233; Ligji për Pyjet e Kosovës Nr.03/L-153; Ligji për Ujrat e Kosovës Nr.04/L-147; Nenin 11.1 të Rregullores Komunale për Transparencë Npi– 01/205 datë: 14.07.2017; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Kuvendi i Komunës së Shitimes në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2022 aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR TA NXJERRË NË DISKUTIM PUBLIK
PROPOZIM-PLANIN LOKAL TË VERPRIMIT PËR BIODIVERSITET 2021-2026**

I

Kuvendi Komunës së Shitimes, në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më: 29.04.2022, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Propozim-Planin Lokal të Verprimit për Biodiversitet 2021-2026, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Shërbime Publike në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shitimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi